




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-2592/14</u>
Dep. <u>02</u>	Prot No. <u>11.07.2014</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Date Datum <u>11.07.2014</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.07.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1996-14 për z.Selajdin Bytyqi–Anëtar i Bordit të Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ambienti”-Istog, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-1996-14, për Zyrtarin e lartë, z. Selajdin Bytyqi–Anëtar i Bordit të Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ambienti” dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Selajdin Bytyqi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z-D/DPK-01-2189/14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Bytyqi është deklaruar se do t’i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Bytyqi, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar një shkresë zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) “Informata mbi biznesin” (DPK-03-2440-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, N.p.“Çeliku” S.B., z.Bytyqi, pronar i biznesit, ka emruar një “person të besuar” në funksionin e personit të autorizur, ashtu siç e parasheh edhe ligji, duke parandaluar kështu konfliktin e interesit me funksionin e tij publik–Anëtar i Bordit të Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ambienti” - Istog.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

